



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:205063

Datë: 17.01.2025

Numri i dokumentit: 06721465

KPPP.nr.1669/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi Prishtina Sh.A. me seli në Prishtinë, me adresë në rr. “ Hazir Shala” nr.4, kundër debitorit N.Sh “Vëllezërit Berisha”, fshati Bërnice e Ulët, p.n., Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.116/21 të datës 25.01.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka me zyre në Prishtinë, duke vepruar sipas vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 1655/23 të datës 11.06.2024 të Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, jashtë seancës, me datë 17.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET pjesërisht prapësimi i debitorit N.Sh “Vëllezërit Berisha” ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.116/21 i datës 25.01.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, për borxhin në shumë prej 140.86 EUR, që i referohet periudhës kohore nga data 01.01.2013 e deri më datë 31.12.2017.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit N.Sh “Vëllezërit Berisha”, ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.116/21 të datës 25.01.2021, të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka, sa i përket borxhit në shumë prej 1,238.35 EUR, që i referohet periudhës kohore nga data 31.01.2018 e deri më datë 31.12.2020.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit KRU “Prishtina” Sh. A, me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.116/21 të datës 25.01.2021, me të cilin ka

lejuar përbarimin në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit me shifër K017444 për periudhën kohore nga data 01.01.2013 e deri më 31.12.2020, duke obliguar debitorin që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'i paguaj kreditorit borxhin prej 1.379.21 €, si dhe shpenzimet e përbarimit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se kartela financiare nuk paraqet dokument të besueshëm e po ashtu ka skaduar afati kohor brenda të cilit sipas ligjit mund të kërkohet përbarimi, ngase kërkesa është parashkruar konform dispozitave të nenit 360 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD). I ka propozuar gjykatës që të aprovoj prapësimin e debitorit si të bazuar dhe të refuzoj urdhrin e lejuar nga përbaruesi privat.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të pa argumentuar dhe se e njëjta nuk ka bazë ligjore dhe nuk mbështetet në prova. Më tutje ka theksuar se debitori ka realizuar pagesa të pjesshme dhe i njëjti në kuptim të nenit 368 të LMD ka pranuar borxhin. Tutje ka theksuar se debitori është faturuar si biznes andaj, parashkrimin për biznes e rregullon neni 353 i LMD-se prandaj prapësimi i debitorit nuk është i mbështetur në ligj. I ka propozuar gjykatës që në bazë të provave të bashkangjitura ta hedhë poshtë prapësimin e debitorit si të pa bazuar dhe të pa argumentuar dhe njëkohësisht të obligohet debitori që të kryej obligimin e tij.

Gjykata, me aktvendimin KPPP.nr. 924/22 të datës 25.09.2023, në pikën I të dispozitivit ka pranuar pjesërisht prapësimin e debitorit NSH "Vëllezërit Berisha" ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përbarimor P.nr.116/21 të datës 25.01.2021 për borxhin në shumë prej 195.07 EUR. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit Përbarimor P.nr.116/21 të datës 25.01.2021, sa i përket borxhit në shumë prej 1,184.00 EUR.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 1655/23 të datës 11.06.2024 ka aprovuar në tërësi ankesën e palës kreditore ashtu që ka anuluar aktvendimin KPPP.nr. 924/22 të datës 25.09.2023 të Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj gjykate, dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje.

Në arsyetimin e saj, është kërkuar nga Dhomat e Shkallës së Parë të kësaj gjykate që të eliminohen kundërthëniet në mes dispozitivit të aktvendimit dhe pjesës arsyetuese të saj meqenëse në pikën I të dispozitivit, urdhri përbarimor P.nr.116/21 të datës 25.01.2021 është shfuqizuar në shumën prej 195.07 EUR, ndërsa në arsyetimin e vendimit ceket se ky urdhër është

shfuqizuar në vlerën prej 713.02 EUR. Po ashtu, është kërkuar që të vlerësohet fakti se a kemi të bëjmë me ndërprerje të afatit të parashkrimit për shkak të pagesave të kohë pas kohshme nga debitori.

Gjykata pas shqyrtimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke marrë për bazë vërejtjet e dhëna nga Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj Gjykate përmes aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 1655/23 të datës 11.06.2024, duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Ekstraktin e verifikuar nga librat afarist me Nr. K017444 e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në të janë treguar palët, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Ndërsa, duke vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me afatin e parashkrimit, Gjykata, pas vlerësimit të kohës së arritjes për pagesë të faturave që janë objekt i ekstraktit nga librat afarist, duke iu referuar dispozitave të nenit 355 paragrafi 1, dhe paragrafi 2 të LMD-së, ka arritur në përfundim se kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar.

Kështu me dispozitën e nenit 355 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të të njëjtit nen përcaktohet se: “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.*

Në rastin konkret, duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturat e pasqyruara në ekstrakt nga data 01.01.2013 deri me datën 31.12.2017 në shumën prej 140.86 EUR kanë arritur afatin e parashkrimit për faktin se propozimi për përmbarim lidhur me borxhin e krijuar në këtë periudhë kohore është ushtruar me datë 22.01.2021, pra pas kalimit të më tepër se 3 (tri) vite nga koha e arritjes së tyre për pagesë.

Rrjedhimisht prapësimi i debitorit në raport për këtë pjesë të borxhit gjen mbështetje në kuptim të nenit 71, par.1, nën-par 1.10 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore i cili përcakton se: “1. Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.10. kërkesa nga dokumenti përmbarues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve”, andaj edhe u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktvendimi, që urdhri për lejimin e përmbarimit të anulohet në shumën prej 140.86 EUR.

Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr.116/21 të datës 25.01.2021 për borxhin në vlerë prej 1,238.35 EUR, pasi që kjo shumë e borxhit është akumuluar në periudhën kohore nga data 31.01.2018 e deri me datë 31.12.2020, dhe meqenëse propozimi për përmbarim është ushtruar me datë 22.01.2021, rezulton të jetë paraqitur brenda periudhës tre (3) vjeçare nga dita kur secila kërkesë është bërë e arritshme.

Gjykata morri për bazë vërejtjet e dhëna nga Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj Gjykate që të vlerësohet fakti se a kemi të bëjmë me ndërprerje të afatit të parashkrimit për shkak se debitori ka ekzekutuar pagesa të kohë paskohshme për kreditorin por gjeti se në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me ndërprerje të afatit të parashkrimit.

Deri tek ky vlerësim Gjykata erdhi pasi që nga ekstrakti nga librat afarist i cili përfshin borxhin e akumuluar nga data 01.01.2013 e deri më datë 31.12.2020 rezulton se debitori, ka bërë dy pagesa dhe atë me datë 07.06.2017 shumën prej 50,00 EUR si dhe me datë 12.10.2018 shumën prej 50.00 EUR. Pagesat në fjalë, nuk i referohen përmbushjes së detyrimit në raport me faturat specifike që janë pjesë e ekstraktit afarist, por evidentohen si pagesa të përgjithshme.

Në këto të gjetura, gjykata iu referua nenit 293 par.1 të LMD-së i cili përcakton se “Kur midis personave të njëjtë ekzistojnë disa detyrime të njëlllojta, kështu që atë që debitori e përmbush nuk mjafton për t’i plotësuar të gjitha, atëherë, në qoftë se për këtë gjë nuk ekziston marrëveshja e kreditorit dhe debitorit, llogaritja bëhet me atë radhë të cilën e cakton debitori më së voni me rastin e përmbushjes”, në lidhje me paragrafin 2 të këtij neni i cili parasheh se “Kur nuk ekziston

deklarata e debitorit mbi llogaritjen, atëherë detyrimet përmbushen me radhë ashtu sikurse kanë arritur për përmbushje”.

Në kuptim të dispozitës së lartcekur, rezulton se në rastet kur mes palëve ka detyrime të një lloji, ashtu sikurse në rastin konkret, ndërsa pala debitore ekzekuton pagesa të pjesshme që nuk përmbushin borxhin në tërësi, dhe në të njëjtën kohë nuk përcakton se cilin pjesë të detyrimit e përmbush përmes pagesave të pjesshme, pagesat në fjalë, do të konsiderohen se përmbushin detyrimet sipas radhës, pra duke filluar detyrimi më i vjetër i arritur për pagesë e deri tek detyrimi i fundit i arritur për pagesë.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se pagesa e datës 07.06.2017 në shumë prej 50,00 EUR dhe pagesa e datës 12.10.2018 në vlerë prej 50,00 EUR, duke mos qenë të specifikuar se cilën pjesë të borxhit total e përmbushin, konsiderohet se kanë përmbushur detyrimet më të vjetra që kanë arritur për pagesë, pra detyrimet e akumuluar që nga data 01.01.2013 e tutje sipas me radhës.

Kësisoj, pagesat e lartcekura nuk mund të merren si pohim i tërësishëm i borxhit të debitorit për kreditorin, rrethanë kjo që do paraqiste bazë për ndërprerjen e parashkrimit, por që përmes këtyre pagesave, konsiderohet se debitori ka pohuar vetëm borxhin i cili ka qenë i arritur për pagesë sipas radhës, pra borxhit të krijuar para datës 31.01.2018.

Nga të lartcekurat, e në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr. 1669/24, datë 17.01.2025

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.